



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 18 prill 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Verica Çeraniq, Andin Hoti, Muharrem Nitaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Zafir Berisha dhe Albert Kinolli.

Munguan: Faton Topalli dhe Ali Lajçi.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Ilir Salihu, Vlora Spanca, Shkëlqim Xhema nga ZKA-ja; Mentor Hyseni nga GIZ; dhe Valbona Bytyçi, Egzona Avdiu, Edona Asllani nga “Ekonomia online”.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.3.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore;
4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i auditimit për vitin 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.3.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore

Kryetari njoftoi se sot jemi mbledhur për të shqyrtuar raportin e auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore dhe shqyrtimin e planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i auditimit për vitin 2016. Por, mosardhja e përfaqësuesve të KGJK-së, e pamundëson shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Shqipe Pantina, tha kjo mospërgjigje ndaj ftesës sonë, tregon joseriozitet ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe KMFP-së, andaj unë propozoj që të ftojme edhe një herë KGJK-në, për të raportuar para KMFP-së. Nëse nuk i përgjigjet ftesës, rekomandoj që raporti i auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore, të përcillet në seancë plenare.

Andin Hoti, propozoi që prapë të ftohen përfaqësuesit e KGJK-së, në takimin e radhës së KMFP-së. Në të kundërtën, raporti duhet të shkojë në seancë plenare.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të KMFP-së.

4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i auditimit për vitin 2016

Kryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Qeveria ka dorëzuar planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i auditimit për vitin 2016. Është hera e parë që Qeveria po raporton në këtë formë. Me këtë hapi diskutimin.

Ilir Salihu, përshëndeti për këtë hap që e ka ndërmarrë Qeveria, për herë të parë, për të hartuar një plan veprimi, gjë që ka munguar në të kaluarën. Qeveria nuk ka pasur një pasqyrë të qartë të rekomandimeve dhe aktiviteteve që duhet ndërmarrë, për t'i zbatuar këto rekomandime dhe si rezultat e kemi pasur një gjendje jo të mirë dhe vazhdojmë ta kemi ende në planin e zbatimit të rekomandimeve, për pasojë kemi një numër të rekomandimeve, të përsëritura prej vitit në vit. Pra, në shumicën e organizatave buxhetore nuk kanë treguar një përkushtim për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste, mungojnë afatet e zbatimit, mungojnë aktivitetet për rekomandimet e dhëna, ndërkaq kur raportohet për nivelin e zbatimit ose thuhet se është në proces, ose është i zbatuar, por nuk jepet një kualifikim më i detajuar se në cilën fazë të procesit është, ndërsa për ato që janë zbatuar, do të duhej të jepet një informatë se në çfarë forme është zbatuar, a është zbatuar ashtu siç është dhënë në rekomandimin e auditorit apo ka pasur një

modifikim, sepse është evidente që rekomandimet tona, nganjëherë janë të një niveli të përgjithshëm dhe nganjëherë organizatat buxhetore e kanë të paqartë çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për t'i zbatuar rekomandimet tona, prandaj do të ishte mirë që në raportet për rekomandimet që janë zbatuar, të jepet një përshkrim sesi janë zbatuar ato rekomandime. Po ashtu, kishte qenë mirë që Qeveria të caktojë një titullar të këtij dokumenti, pasi, sa që kam parë unë, në vendimin e Qeverisë thuhet se aprovohet plani dhe kërkohet zbatimi i rekomandimeve, por pastaj raportimi nuk dihet kujt i shkon dhe çfarë ndodh, nëse ka ngecje në implementimin e rekomandimeve. Kështu që, si këshill e imja do të ishte që Qeveria të caktojë një titullar të këtyre raporteve buxhetore, pastaj të krijohet një mekanizëm për monitorimin e progresit dhe hapave që duhet të ndërmerren, nëse ka ngecje nëpër institucione.

Shqipe Pantina, theksoi se pajtohet me këto që i tha zëvendësauditori. Ministria e Financave mban takime të rregullta vjetore me komunat, për diskutuar për këto probleme dhe për të gjetur zgjidhje. Por, kjo nuk është masë e mjaftueshme. Ajo që ka rëndësi, është se kujt i kërkojmë përgjegjësi për këtë plan. Natyrisht, titullari është Kryeministri. Po ashtu, dua të theksoj se qeverisja e re duhet të marrë përsipër edhe obligimet nga qeverisja e vjetër, plani duhet jetë vazhdimësi e qeverisjes.

Avdullah Hoti, tha se nuk e di që në të kaluarën ka pasur ndonjë praktikë të tillë, që për planin e veprimit të ftojme Qeverinë për raportim, sepse ajo harton planin e veprimit dhe nuk është e nevojshme, sepse plani i veprimit është vetëm sa për informim.

Andin Hoti, propozoi që prapë të ftohen përfaqësuesit e Kryeministrit në takimin e radhës së KMFP-së. Në të kundërtën, raporti duhet të shkojë në seancë plenare.

Përfundim

KMFP vendosi që plani i veprimit të Qeverisë për të gjeturat e Raportit të auditimit për vitin 2016, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të KMFP-së.

5. Të ndryshme

Kryetari informoi deputetët se janë pajtuar me ZKA-në, që raportet e auditimit, të finalizuar nga viti i kaluar, menjëherë t'ia dorëzojnë komisionit për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj